

Nella ricorrenza della festa dell'Indipendenza del Kosovo (17 febbraio 2024) assegnato dal Ministro della Cultura al prof. Anton Berisha, già professore di Letteratura albanese presso il nostro Ateneo, per il contributo da lui portato con i suoi studi critici alla conoscenza della letteratura arbereshe una delle massime onorificenze nazionali che porta il nome del letterato kosovaro "Azem Shkreli". Al prof. Berisha vanno le più vive felicitazioni da parte dei colleghi della cattedra di Albanologia, dei colleghi del Dipartimento e degli altri Dipartimenti dell'UNICAL che hanno avuto modo di frequentarlo e da parte degli studenti che si onorano di averlo avuto apprezzato docente nei corsi da lui tenuti ininterrottamente presso l'Università della Calabria dal 1992 al 2016.

KOHA DITORE

KULTURË

“Azem Shkreli” për Anton Nikë Berishën si zë i letërsisë arbëreshe

[Nga Besartë Elshani](#) 16 shkurt 2024



“Puna më e rëndësishme është se ky çmim mban emrin e një prej krijuesve më të mëdhenj që kemi pasur e që kemi”, ka thënë Anton Nikë Berisha, pasi ka pranuar çmimin në ceremoninë e mbajtur të premtën në Ministrinë e Kulturës

Studiuesi i letërsisë, shkrimtari, përkthyesi e mësimdhënësi universitar edhe në Universitetin e Kalabrisë, Anton Nikë Berisha, është shpallur laureat i çmimit kombëtar letrar për vepër jetësore “Azem Shkreli”. Është vlerësuar për studimet letrare në veçanti të autorëve arbëreshë, por edhe të autorëve të tjerë shqiptarë. Ministria e Kulturës ka ndarë edhe çmimet e tjera tradicionale, pos atij për veprën më të mirë për fëmijë dhe të rinj “Vehbi Kikaj”. Ndërkaq është propozuar themelimi i një çmimi të ri

Anton Nikë Berisha është laureati i sivjetmë i çmimit kombëtar letrar për vepër jetësore “Azem Shkreli”. Ministria e Kulturës ia ka ndarë çmimin për përkushtimin e Berishës ndaj letërsisë arbëreshe.

Juria e përbërë prej Bardh Rugovës, kryesues dhe anëtarëve Azem Deliu, Vlora Ademi, Alban Beqiraj dhe Naime Beqiraj, në arsyetim ka përmendur kontributin e tij jetësor, duke u veçuar “si studiues i letërsisë, shkrimtar dhe përkthyes, i cili një pjesë të madhe të shekullit të tij studimor e ka kaluar si mësimdhënës universitar në Universitetin e Kalabrisë, Itali.

Profesori Bardh Rugova, derisa ka lexuar arsyetimin e jurisë, ka thënë se veprat e Berishës kanë qenë kryesisht studime për arbëreshët.

“Berisha është marrë me studime letrare, në veçanti të autorëve arbëreshë, por edhe të autorëve të tjerë shqiptarë, me veprën e autorëve të vjetër shqiptarë, me probleme të teorisë së letërsisë, si dhe me çështje të letërsisë popullore shqiptare. Prej vitit 1993 deri në pensionim ka mbajtur mësim për letërsinë shqiptare në Katedrën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe në Universitetin e Kalabrisë. Paraprakisht, për dy dekada ka punuar asistent fillimisht, por pastaj bashkëpunëtor shkencor, bashkëpunëtor i lartë shkencor dhe në fund këshilltar shkencor në Institutin Albanologjik në Prishtinë”, ka thënë Rugova.

Laureati i sivjetmë, Anton Nikë Berisha, pasi ka pranuar çmimin nga ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku, ka thënë se ndihet i nderuar me çmimin që mban emrin e krijuesit të madh shqiptar, Azem Shkreli.

“Puna më e rëndësishme është se ky çmim mban emrin e një prej krijuesve më të mëdhenj që kemi pasur e që kemi. Jam marrë edhe me punën e letërsinë e Azem Shkrelit. Nuk e di sa ka qenë e vlefshme ajo, por jam marrë nga parathënia e një kompleti e deri në çastet e fundit nuk jam shkëputur prej tij. Emri dhe vepra e tij i bëjnë nder jo vetëm atij që merr një shpërblim në emër të tij, por u bëjnë nder letërsisë shqipe, kombit tonë”, ka thënë Berisha.

Çmimi për veprën më të mirë në prozë “Anton Pashku” i është dhënë Afrim Demirit për përmbledhjen me tregime “Figura e 17-të”. Ai për veprën më të mirë në poezi “Ali Podrimja” i është ndarë Halil Matoshit për përmbledhjen me poezi “Lil’s poem”. Çmimi për veprën më të mirë në kritikë letrare dhe eseistikë “Ibrahim Rugova” është ndarë për dy autorë: Kujtim Shalës për veprën “Kënga e cjamin” dhe Nysret Krasniqit për veprën “Ekuilibri letrar”. Çmimi për veprën më të mirë të përkthyer në gjuhën shqipe “Pjetër Bogdani” i është ndarë Blertë Ismajlit për përkthimin e veprës së Jurgen Habermasit – “Transformimi i ri i sferës publike dhe politika deliberative”

Pos çmimit për vepër jetësore janë ndarë edhe të tjera çmime në fushën e letërsisë.



Çmimi për veprën më të mirë në prozë “Anton Pashku” i është dhënë Afrim Demirit për përmbledhjen me tregime “Figura e 17-të”. Shkrimtari Demiri, çmimet në përgjithësi i ka konsideruar nxitëse për avancimin e librit. “Shënon një moment nxitës edhe në raport me lexuesin, edhe aq më tepër në raport me kohën kur ka tendenca socio-ekonomike që libri të marginalizohet. Mendoj se libri do të mbijetojë. Do t’u mbijetojë edhe transformimeve teknologjike. Qoftë edhe në formë elektronike. Në një rast më është imponuar të them se libri do ta mbijetojë edhe kohën digjitale, pasi askush më mirë se letërsia nuk e ngërthen kompleksitetin e njeriut”, ka thënë ai. Çmimi për veprën më të mirë në poezi “Ali Podrimja” i është ndarë Halil Matoshit për përmbledhjen me poezi “Lil’s poem”. “Faleminderit jurisë! Është nder për mua. Me këto çmime e shohim se nuk na shkon munda huq”, ka thënë shkurt Matoshi. Çmimi për veprën më të mirë në kritikë letrare dhe eseistikë “Ibrahim Rugova” është ndarë për dy autorë: Kujtim Shalës për veprën “Kënga e cjamin” dhe Nysret Krasniqit për veprën “Ekuilibri letrar”. “Mendoj se librat e kanë rrugën e tyre. Këta libra janë më specifikë, por është shumë gjë e mirë të nderohen autorët”, ka thënë Nysret Krasniqi. Çmimi për veprën më të mirë të përkthyer në gjuhën shqipe “Pjetër Bogdani” i është ndarë Blertë Ismajlit për përkthimin e veprës së Jurgen Habermasit – “Transformimi i ri i sferës publike dhe politika deliberative”.

Ismajli ka thënë se ka qenë përgjegjësi e madhe marrja përsipër e kësaj vepre për ta sjellë në gjuhën shqipe. Ka përmendur se libri është tekst për një grup të kufizuar lexuesish.

“Jam në radhën e dytë, atë të personit të padukshëm. Jemi në prapavijë, nuk na sheh njeri. Mundohemi të bëjmë ndërlidhjen ndërmjet gjuhëve dhe kulturës. Një tentim për të sjellë një

kontribut në rrafshin e dijes, një tekst teorik në fushën e sociologjisë, komunikimit masiv”, ka thënë Ismajli.

Derisa është folur për rëndësinë e përkthimit të veprave të huaja në shqip, laureati i sivjetmë, Anton Nikë Berisha, ka propozuar që të themelohet edhe një tjetër çmim për përkthimin e veprave nga shqip në gjuhët e huaja.

Ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku, ka thënë se “përkthyesi i një vepre është si autor i dytë i asaj vepre”.

Sivjet çmimi për veprën më të mirë për fëmijë dhe të rinj “Vehbi Kikaj” nuk është ndarë. Juria ka bërë të ditur se ka vendosur që sivjet të mos jepet çmimi “për shkak të prurjeve të varfra”.

Pos çmimit kombëtar për vepër jetësore “Azem Shkreli”, që ka vlerën financiare 5 mijë euro, çmimet e tjera kanë vlerën monetare prej 2.500 eurosh.

Anëtari i jurisë, poeti Azem Deliu, i ka rekomanduar Ministrisë që të rritet vlera e shpërblimit të çmimeve.

“Ndonëse çmimet në kohën kur janë themeluar, kanë përfaqësuar vlerë të mjaftueshme edhe materiale, kjo sot nuk është më e vërtetë për autorët që kemi nderuar e do t’i nderojmë”, ka thënë ai.

Tradicionalisht MKRS-ja këto çmime i ka ndarë në shënimin e Ditës së Pavarësisë së Kosovës, më 17 Shkurt.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.